



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

DREJTORIA LIGJORE

SEKTORI I PROCEDURAVE LIGJORE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Durrës, më 18.06.2026

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Orendi e pajisje gjimnazi Manëz”.*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): *Artikuj mobilimi 39516000-2.*

VLERA E FONDIT LIMIT: *5,154,955 (pesë milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH.*

Afati i lëvrimit të mallit: *60 (gjashtëdhjetë) ditë, nga dita e nënshkrimit të kontratës.*

Argumentim:

MBI PËRLLOGARITJEN E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS DHE PËRGATITJEN E
SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.69 e nr.2773 prot., datë 25.02.2026 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përllogaritjen e fondit limit, për procedurën e prokurimit me objekt: *“Orendi e pajisje gjimnazi Manëz”*, të planifikuar për tu kryer në programet e investimeve për vitin 2026-2028.

Grupi i specifikimeve teknike, në zbatim të nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, iu drejtua me shkresë zyrtare Institutit të Statistikave Tiranë, Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, Bashkisë Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkisë Durrës: Sektorit të prokurimeve , respektivisht me shkresat nr.13188/2 prot, datë 10.12.2025; nr.13188/3 prot, datë 10.12.2025; nr.13188/1 prot, datë 10.12.2025; nr.13188/4 prot, datë 10.12.2025 ,me objekt “Kërkesë për informacion mbi çmimet reference zyrtare për prokurim publik” .

Instituti i statistikave Tiranë, me shkresën nr.2216/1 prot., datë 17.12.2025 me tonën nr.13188/6 prot.,datë 19.12.2025, nuk ka ofruar informacionin e kërkuar për mungesë të dhënash të disponueshme. Operatori i

Blerjeve të Përqendruara, me shkresën nr.4207/1prot., datë 17.12.2025 me Tonën nr. 13188/5 prot., datë 18.12.2025, ka ofruar informacion për disa nga artikujt e kërkuar. Bashkia Tiranë: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, nuk i është përgjigjur kërkesës. Bashkia Durrës: Sektori i prokurimeve, me shkresën nr.13188/7 prot., datë 24.12.2025, ka vënë në dispozicion listën e çmimeve dhe specifikimet teknike për kontratën e furnizimit nr.781 prot., datë 17.01.2025, me objekt prokurimi “Pajisje mobilierie arsim i mesëm i përgjithshëm”.

Gjithashtu, i jemi drejtuar studimit të tregut, me objekt: “Kërkesë për ofertë” drejtuar 3 (tre) subjekteve operatorëve ekonomike të cilat janë të administruara në dosje. Kërkesat drejtuar 3 (tre) subjekteve janë të shoqëruara me specifikimet teknike të artikujve.

Nga analiza e ofertave të tregut të ardhura nga tre operatorët, bazuar në nenin 76/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili shprehet - *studimi i tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra....*-, mesatarja e çmimeve të tre ofertave krahasuar me çmimet e OBP-së që i përkasin vitit 2025 si dhe me çmimet e artikujve në kontratën e furnizimit nr.781 prot., datë 17.01.2025 e cila është e afërt në kohë, rezultojnë të jenë minimalisht mbi 10 % më të larta.

Si rrjedhojë, duke përdorur ofertat e tregut si element krahasues, përcaktimi i vlerës së fondit limit është bazuar në nenin 76/a dhe 76/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pra në çmimet e referencës së OBP-së për artikujt që ky institucion mbulon dhe në çmimet sipas kontratës së ngjashme për artikujt që nuk i mbulon OBP-ja.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit,*

sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriteve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 2, germa c) e 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor. Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3, ku përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit", si dhe duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar"; Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar; kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar. Ky kriter, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, siguron qëndrueshmëri financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST si dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i" dhe "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025, ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë*

Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.2 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tri) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar me cilësi kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

Aftësitë teknike dhe profesionale të tjerat si më poshtë janë hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues:

- a) Në rast se është prodhues i mobiljeve të drurit duhet të ketë të punësuar një staf punonjësish të deklaruar, minimalisht 8 persona për periudhën e tre muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Me qëllim plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore, shoqëruar me listëpagesat e periudhës së kërkuar (të firmosura dhe vulosura nga Administrata Tatimore/ në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi).

- b) Në rast se është tregtar i mobiljeve te drurit duhet te kete të punësuar nje staf punonjesish minimalisht 5 persona te deklaruar per periudhën e tre muajve te fundit nga data e hapjes se ofertave. Me qëllim plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore, shoqëruar me listëpagesat e periudhës së kërkuar (të firmosura dhe vulosura nga Administrata Tatimore/ në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi). Tregtar në këtë rast do të quhen edhe ato operatorë ekonomikë të cilët mund të jenë vetë prodhues për një pjese të artikujve dhe tregtarë për pjesën e mbetur të artikujve të kërkuar nga AK. Operatori ekonomik duhet të dorezojë një deklaratë ku të shprehë listën e artikujve që i prodhon vetë dhe artikujt që vetëm i tregton.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimin dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Nga ana e AK është kërkuar nje numer punonjesish prej 7 personash, sepse kontrata eshte komplekse, me shume artikuj ku kerkohen punonjes te specializuar ne procese specifike te prodhimit te mallrave objekt prokurimi. Shume artikuj jane prodhim sipas permasave te percaktuara ne planet perkatese te mobilimit qe kerkon precision, cilesi dhe shpejtesi ne te njejtën kohe. Te gjithë artikujt jane parashikuar te jene Furnizim Vendosje, pra pervec prodhimit dhe shperndarjes kemi te perfshire edhe procesin e montimit qe kerkon punonjes te tjere. Konkretisht analiza në lidhje me numrim e punonjësve për rastin kur operatori është prodhues dhe tregtar paraqitet si më poshtë vijon: Në bazë të përlllogaritjeve, nisur nga sasia e produkteve të kërkuara, nevojitet staf, si më poshtë vijon: Nisur nga volumi i mallrave, llogariten rrugë transporti me kamionë mbi 1.5 ton, Shofer- 1 person , Punëtorë ngarkim shkarkimi, montim,prodhim - 7 punëtorë Total- 8 punonjes, ndersa ne rastin kur eshte tregtar mobiljeve te drurit minimalisht duhen 5 punonjes nder to Shofer- 1 person.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 1(një) mjet transporti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mallrash. Mjeti i transportit mund të jenë në pronësi ose me qira. Pronësia e mjeteve të mësipërme vërtetohet:

- Mjetet në pronësi të shoqërohen me: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë: kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi origjinal ose kopje të noterizuara); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

- Mjetet me qira të shoqërohen me: a)kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten

e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjete (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme)

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Referuar specifikimeve të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë venddorezimit të tyre në destinacionin perkates, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi. Është kërkuar një kamion mallrash me peshe mbi 1.5 ton, i pershtatshëm për transport mallrash për të vertetuar që ofertuesit pjesëmarrës kanë automjetin e nevojshëm për transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën, reputacionin dhe besueshmërinë duke qene se kontrata përmban artikuj të ndryshëm të cilet duhet të transportohen dhe të bëhet furnizim vendosja e tyre në shkollën e përcaktuar në objekt prokurimi.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresën e përcaktuar në grafikun e shpërndarjes

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Ky kriter vendoset në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet .

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit të artikujve), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre, si dhe ndërrimin në raste defektesh si dhe deklaratë për cilësinë dhe origjinën e mallrave, objekt i këtij prokurimi.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor se operatori merr përsipër zëvendësimin e mallrave dhe levrimit sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci për mallrat e ofruar si dhe ndërrimin në rast se nuk janë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK .

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për të vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës*

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës dhe në rastin kur ai nuk është prodhues të paraqesë certifikatën përkatëse të prodhuesit/distributorit të autorizuar të mallrave objekt prokurimi, si më poshtë:

- A.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e cilesise se punimeve ISO 9001- 2015 (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) të perdituesar. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallarave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
- B.** Operatori ekonomik, vetëm në rastin kur është prodhues duhet të paraqesë Certificate ISO 14001-2015 (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), të perdituesar. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallarave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
- C.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë), të perdituesar. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallarave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentim: *Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nga ana e AK është kërkuar zotërimi i certifikatave:*

ISO 9001- 2015 - Certificate e cilesise se punimeve Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin pajisjet e mobiljeve për nxënësit e arsimit parauniversitar me qëllim furnizimin me pajisje cilësore nisur nga fakti që bëhet fjalë për institucione arsimore dhe nisur nga kohëzgjatja e konsiderueshme që përdoren këto pajisje, vlerësohet që zotërimi i një certificate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

ISO 14001-2015 – Certificate per menaxhimin e sistemit mjedisor Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin prodhimin e pajisjeve të mobiljeve për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe duke qenë

se ky proces sjell ndikime në mjedis vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet. OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 - Certificate per menaxhimin e sistemit te sigurise dhe shendetit Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin një sërë procesesh të cilët kërkojnë cilësi dhe operatorët ekonomikë në këtë fushë duhet të zotërojnë një numër të lartë makinerish dhe duhet të kenë të punësuar kryesisht një numër të lartë punonjësish vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

2.4.4 Në rastin kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve/ artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë:

A. Autorizim Prodhuesi ose Autorizim Distributori, për pajisjet e ofertuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe në nenin 40, pika 8, të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Kjo kërkesë është përcaktuar me qëllim që të sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe ploteson specifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratës, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Ky kriter është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, si dhe përfshirjen dhe suportin e prodhuesit, përmes vet atij apo distributorit të autorizuar.*

B. Katalogë / broshura / foto ilustruese ose cdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, për paisjet e kërkuara duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga paisjet e ofruara me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse paisjet e ofruara janë sipas specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit. Fleta ose fletët e katalogut/broshurës për paisjet duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të pikës 4 të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që me paraqitjen e katalogut të bëhet i mundur një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara, për të përmbushur kontratën Autoriteti kontraktor synon verifikim e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë ofertues me ato të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit.*

“Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë...” roshurës për paisjet nëse nuk janë në gjuhën shqipe duhet të paraqiten të përkthyer dhe noterizuar.

2.4.5 Operatori ekonomik për artikujt e kërkuar duhet të paraqesë certifikatat e produktit si më poshtë:

1. Tavolinë nxënësi cikli i lartë -2 vendeshe: SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-1:2015/AC:2016, SSH EN 1729-2:2023.
2. Karrige nxënësi cikël i lartë : SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012+A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar
3. Tavolinë mësuesi cikli i lartë, arsimit të mesëm : SSH EN 527-1:2011 ose ekuivalenti i tij; SSH EN 527-2:2016 +A1:2019 ose ekuivalenti i tij.
4. Karrige për mesues me tapiceri: SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018(EN, e njëvlefshme ose e përditësuar
5. Dollap për klasa : EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015(EN, e njëvlefshme ose e përditësuar
6. Dërrasë e zezë : EN 16121:2023 SSH EN 14434:2023
7. Karrige për kabinetet : SSH EN 1728:2012, SSH EN 1022:2023
8. Tavolinë për kabinet treshe: SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012 + A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar
9. Tavolinë për kabinet dyshe: SSH EN 1729-1:2015, SSH EN 17292:2012 + A1:2015, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar
10. Dollap për kabinetin e kimisë, biologjisë dhe fizikës: EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015(EN, e njëvlefshme ose e përditësuar
11. Tavolinë nxënësi dyvendëshe për kompjuter - Arsimit të mesëm : SSH EN 1729-1:2015: SSH EN 1729-1:2015/AC:2016, SSH EN 1729-2:2023
12. Tavolinë mësuesi për kabinetin e informatikës : SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar).
13. Karrige për nxënësi për kabinetin e informatikës: SSH EN 1728:2012, SSH EN 1022:2023
14. Tavolinë për bibliotekë: SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar), SSH EN 13721:2004
15. Raft për bibliotekën: EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015(EN, e njëvlefshme ose e përditësuar
16. Karrige bibliotekë SSH EN 1728:2012, SSH EN 1022:2023
17. Tavolinë drejtuesi në formë L-je e madhe SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)
18. Tavolinë drejtuesi në formë L-je e vogël SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527- 2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)
19. Karrige rrotulluese drejtuesi me rregullim lartësie SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018
20. Tavolinë zyre SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)
21. Raft/Dollap për zyra kërkesat e Standartit EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015(EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)
22. Karrige zyre e thjeshtë kërkesat e standartit SSH EN 1335-1:2020+A1:2022, SSH EN 1335-2:2018 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)

23. Tavolinë mbledhje ovale SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016 + A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar).
24. Karrige për sallën e mësuesve SSH EN 1728:2012, SSH EN 1022:2023
25. Raftë për çdo mësues në sallën e mësuesve EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015(EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)
26. Dollap gardierobë për stafin
27. Tavolinë për sallë polifunkionale SSH EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019 (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar).
28. Karrige për sallën polifunkionale SSH EN 1728:2012, SSH EN 1022:2023
29. Dollap për arkivin EN 16122:2012, (EN, e njëvlefshme ose e përditësuar)
30. Shtrat vizite për infermierinë SSH EN 1725:2023

31. Karrige statike pa krahë mbështetës : SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018,(e njëvlefshme ose e përditësuar).
32. Tabelë shkrimi: EN 16121:2023, SSH EN 14434:2023 ,e njëvlefshme ose e përditësuar
33. Dollap për veshje /zhveshje: EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015, (e njëvlefshme ose e përditësuar)
34. Dollap për veshje /zhveshje45 cm: EN 16122:2012, EN 16122:2012/AC:2015, (e njëvlefshme ose e përditësuar)

SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 e njëvlefshme ose e përditësuar., standart qe percakton dimensionet funksionale te tavolinave per perdorim ne institucionet shkollore dhe parashkollore qe nga mosha 3-14+, duke bere nje klasifikim sipas ngjyrave ne perputhje me moshen dhe gjatesine e femijeve, ne menyre qe te sigurohet nje qendrim sa me rregullt I femijes.

EN 1728-1: 2012,EN 1022:2023, standart qe percakton kerkesat e sigurise qe duhet te permbushin tavolinat per nxenes per perdorim ne institucionet shkollore dhe parashkollore si dhe pershkruan metodat e testimit qe aplikohen per te vleresuar sigurine dhe stabilitetin e keture mobiljeve. Karrige nxenesi cikli i ulët/cikli i lartë

SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015, standart qe percakton dimensionet funksionale te tavolinave per perdorim ne institucionet shkollore dhe parashkollore qe nga mosha 3-14+, duke bere nje klasifikim sipas ngjyrave ne perputhje me moshen dhe gjatesine e femijeve, ne menyre qe te sigurohet nje qendrim sa me rregullt I femijes.

SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015, standart qe percakton kerkesat e sigurise qe duhet te permbushin tavolinat e nxenesve per perdorim ne institucionet shkollore dhe parashkollore qe nga mosha 3- 14+, duke bere nje klasifikim sipas ngjyrave ne perputhje me moshen e femijeve,si dhe pershkruan metodat e testimit qe aplikohen per te vleresuar sigurine dhe stabilitetin e ketyre mobiljeve.

Karrige mesuesi SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe perdoret per te percaktuar kerkesat ne lidhje me dimensionet qe duhet te kete nje karrige per perdorim te zakonshem ne menyre qe te

sigurohet nje qendrim i pershtatshem per te punuar dhe gjithashtu pershkruan edhe metodat e testimave te kryera per percaktimin e tyre. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti i prodhuar respekton keto dimensione.

SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe specifikon kerkesat qe duhet te plotesojne keto karrige per sa i perket sigurise, forces dhe qendrueshmerise per nje perdorim rreth 8 ore ne dite dhe per nje person qe peshon deri ne 110 kg. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti eshte i sigurte per nje perdorim te tille.

Tavolinë mësuesi: EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, standart qe specifikon permasat qe duhet te plotesojne produkti.

EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, ky standard evropian specifikon kerkesat e sigurise, forcës dhe qendrueshmerisë në tavolinat e punës.

Dollap për klasa SSH EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, Standart qe nenkupton qe produkti dollap I eshte nenshtuar testeve qe kane te bejne me ushtrimin e forces dhe peshave te ndryshme qe mund te jene te pranishme gjate funksionimit normal te dollapit. Gjithashtu testeve u nenshtrohen edhe pjeset perberese te dollapit. Nje certifikate te tille nenkupton qe dollapi ne teresine e tij ploteson kerkesat e fortesise, rezistences dhe qendrueshmerise.

Karrige rrotulluese SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe perdoret per te percaktuar kerkesat ne lidhje me dimensionet qe duhet te kete nje karrige per perdorim te zakonshem ne menyre qe te sigurohet nje qendrim i pershtatshem per te punuar dhe gjithashtu pershkruan edhe metodat e testimave te kryera per percaktimin e tyre. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti i prodhuar respekton keto dimensione.

SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe specifikon kerkesat qe duhet te plotesojne keto karrige per sa i perket sigurise, forces dhe qendrueshmerise per nje perdorim rreth 8 ore ne dite dhe per nje person qe peshon deri ne 110 kg. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti eshte i sigurte per nje perdorim te tille. Keto standarte shoqerohen bashke. Nje certifikate e tille nenkupton qe mobilja e prodhuar i ploteson keto standarte.

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente ose të përditësuar me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme për gjatë periudhës së realizimit të procedurës së prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet te jene origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e mesiperme duhet te jene te lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatorët duhet te disponojne certifikatat e kerkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Argumentimi: Neni 44 pika 1,2,3,4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar .Cerifikatat e pikes 2.4.5, kane lidhje te ngushte me objektin e mallrave qe prokurohen dhe perbejne nje standart akreditues thelbesor lidhur me cilesine/sigurine e materialeve ne fushen e mobilimit te dedikuar per ambiente shkollash lidhur me suprinat e tavolinave,karrigave etj, elemente si qendrueshmerine e tyre vecanerisht karshi te nxehtit dhe lageshtise , lidhur me fortesine e materialeve , me pjeset e levizshme te dollapeve/vitrinave apo parametrave te tjere gjate fazes se realizimit te tyre.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s` kualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja gjithmonë e në rritje për mjete të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në specifikimet teknike nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve

Specifikimet teknike i janë referuar katalogut të OBP-së “Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim-2025” si dhe specifikimeve teknike të ardhura nga Ministria e Arsimit.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT,

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit